

V E N D I M
Nr.150, datë 3.4.1993

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE-ARTISTIKE TË PERSONAVE FIZIKË
E JURIDIKË PRIVATË VENDAS E TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka të drejtë të financojë në mjete pune e financiare persona fizikë e juridikë privatë, vendas e të huaj, për realizimin e projekteve kulturore artistike që i shërbejnë zhvillimit të kulturës dhe artit kombëtar.

2. Përballimi i shpenzimeve do të bëhet nga fondet e buxhetit të miratuara për Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të nxjerrin udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi